



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:201189

Datë: 29.09.2023

Numri i dokumentit: 04735996

C.nr.2552/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.H, nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura “MBN” me seli ne Prishtinë, me avokatë Mexhid Syla dhe Blerim Syla, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....” Sh.A., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Yll Musa, i punësuar pranë të paditurës, me objekt kontesti kompensim dëmit, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik të datës 20.09.2023, të mbajtur me prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 29.09.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditëses D.H nga Prishtina.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....,” Sh.A me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksident komunikacioni të datës 02.08.2017, nga baza e auto përgjegjësise, t’ia paguaj shumat si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....1,440.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej1,512.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej200.00€
- Për perkujdesje të personit të huaj, shumën prej150.00€
- Për shpenzimet materiale gjatë shërimit, shumën prej.....506.35€

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S.....” Sh.A me seli në Prishtinë, që për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë si në pikën -II- të këtij dispozitivi, paditëses t’ia paguaj kamatën në lartësi prej 8% në vit, dhe atë për dëmin material nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë, 29.09.2017, kurse për dëmin jo material nga data marrjes së këtij aktgjykimi, 29.09.2023, e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 849.60€, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, mbi shumat e aprovuara si në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: për dhimbje fizike trupore shumën prej 560.00€, për frikën e pësuar shuma prej 848.00€, për përkujdes të personit të huaj shuma prej 50.00€, dhe për rehabilitim fiziko-terapeutik shuma prej 600.00€.

A r s y e t i m

Paditësja, D.H, nga Prishtina, përmes përfaqësuesi të autorizuar, me datë 29.09.2017, në këtë Gjykatë, ka ushtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.....” Sh.A, me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit.

Paditësja, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, në padi, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare kanë theksuar se me datë 02.08.2017, në rrugën “Fatime Sokoli” në Prishtinë, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit rrugor. Deri te aksidenti kishte ardhur me fajin e ngasësit të automjetit nën B (.....), i siguruar tek e paditura, për shkak të ndërrimit të pasigurt të shiritit, godet automjetin nën A (.....). Si pasojë e kësaj goditje lëndime trupore pëson paditësja, D.H. Mbi bazën e këtyre, i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ta detyrojë të paditurën që t’ia kompensojë dëmin si në vijim: në emër të shkaktimit të dhimbjeve fizike shumën prej 2,000.00€; në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2,000.00€; në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 200.00€; në emër të ndihmës nga personi i tretë shumën prej 200.00€; në emër të rehabilitimit klimaterik shumën prej 600.00€ dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën prej 506.35€, apo shumën e përgjithshme prej 5,406.35€, me kamatë ligjore.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 953.60€ dhe atë: 104.00€ për përpilim të padisë, 104.00€ për precizim të kërkesëpadisë, 40.00€ për taksë gjyqësore për padi, 405.60€ për përfaqësimin e paditëses nga avokati në tri seanca gjyqësore, dhe 300.00€ për marrjen e provave me ekspertiza mjekësore.

E paditura Kompania e Sigurimeve “P.....” Sh.A, në përgjigje në padi, në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por e ka kontestuar kërkesëpadinë vetëm për nga lartësia, për dëmin material dhe jo material, me pretendimin se shumatat e kërkuara nuk janë në harmoni me lëndimet e pësuar tek paditësja. Lartësia e kërkesës nuk është në përputhje me praktikën gjyqësore dhe kërkesa për kompensimin e shpenzimeve për rikuperim klimaterik nuk mbështeten në provat materiale. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses mbi shumën prej 800.00€, ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Raportin e aksidentit numër 2014-AR-2077 të datës 02.08.2017, të lëshuar nga Policia e Kosovës; Raportin e Qendrës Emergjente (QKUK) me numër të protokollit 30798, të datës 02.08.2017; Kuponët fiskal: numër 14 i datës 10.08.2017, i datës 03.08.2017 lëshuar nga Star Pharm, numër 6 i datës 31.08.2017, numër 7 i datës 31.08.2017, numër 8 i datës 11.08.2017, numër 13 i datës 09.08.2017, numër 10 i datës 11.09.2017, numër 0008 i datës 29.08.2017, numër 10 i datës 14.09.2017, numër 9 i datës 14.09.2017, numër 13 i datës 25.08.2017, numër 1 i datës 23.11.2017, numër 1 i datës 20.10.2017, numër 1 i datës 14.10.2017, numër 0046 i datës 02.08.2017, numër 3 i datës 16.10.2017, numër 1 i datës 18.10.2017, numër 1 i datës 11.10.2017, numër 1 i datës 02.10.2017, numër 8 i datës 09.10.2017, numër 1 i datës 06.10.2017, numër 2 i datës 09.10.2017, numër 2 i datës 04.10.2017, numër 0107 i datës 29.08.2019, numër 1 i datës 02.10.2017, numër 1 i datës 06.10.2017, dëftesat me numra 0112741, 0214771, 156819, 092588, 089996, 265286, dhe Ekspertizën mjekësore të datës 27.07.2023, të punuar nga ekspertët mjekësor Dr. Arber Tolaj ortoped - traumatolog dhe Dr. Nazmie Musiu psikiatër.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses dhe

vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datën 02.08.2017, kishte ndodhur aksident komunikacioni mes automjetit të markës BMW me targa të regjistrimit, dhe automjetit të markës BMW me targa të regjistrimit, të cilin e drejtonte këtu paditësja D.H. Po ashtu mes palëve nuk ishte kontestues fakti se deri tek kishte ardhur me fajin e të siguruarit të të paditurës, ngasësit të automjetit, i cili ka bërë ndërrim të pasigurt të shiriti, duke penguar automjetin të cilin e ngiste paditësja, e cila edhe pëson lëndime trupore. Fakt ky që provohet edhe me raportin e aksidentit numër 2014-AR-2077 të datës 02.08.2017, të përpiluar nga Policia e Kosovës.

Po ashtu mes palëve nuk ishte kontestues as fakti se shkaktar i aksidentit të komunikacionit, nga ka rrjedhur edhe dëmi, ka qenë i siguruar tek e paditura, me policën e sigurimit numër 0....., e vlefshme deri më 07.07.2018.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet lartësia e kompensimit, për të cilën përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre.

Nga Raportet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës - Qendra Emergjente, me numër 30798, i datës 02.08.2017, Gjykata ka konstatuar faktin se në ditën e aksidentit, paditësja është paraqitur pranë këtij institucioni shëndetësor, e cila ka evidentuar lëndimet e pësuar të paditëses dhe i njëjti kishte pranuar edhe tretman mjekësor.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertizës, me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë dhe psikiatrisë.

Eksperti ortoped - traumatolog Dr. Arber Tolaj, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, e cila gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses, ka konstatuar se paditësja D.H, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore si ndrydhje e kokës, distorzion të unazave të qafës, ndrydhje të kafazit të kraharorit, ndrydhje e regjionit lumbal, ndrydhje dhe gërvishtje të regjionit të dy parakrahëve (dëmtim i shtresës sipërfaqësore të lëkurës së parakrahut të djathtë), cilat cilësohen si lëndime të lehta rënda trupore. Paditësja, si pasojë e lëndimeve të marra, kishte pësuar dhimbje fizike të intensiteve të ndryshme. Dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 15 minutave. Dhimbje fizike të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 ditësh, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 15 ditësh, ndërsa dhimbjet me intensitet të ulët janë prezentë edhe tani, sidomos gjatë

sforcimeve fizike me dorën e djathtë dhe ndryshimeve klimatike.

Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka theksuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 15 ditë, për kryerjen e disa aktiviteteve të përditshme jetësore, e ndihmuar nga familja, sikurse përgatitja dhe ofrimi i ushqimit, veshmbathje, higjiena personale. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 4 javë, i pajisur minerale, albumina dhe vitamina, ushqim më shumë i përforcuar se ai i zakonshmi. Eksperti ka konstatuar se për paditësen ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik klimatik dy herë nga 10 ditë, brenda vitit të parë pas aksidentit. Eksperti ka gjetur se paditësja nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe nuk ka shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Nazmie Musliu, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor e cila gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses, ka konstatuar se paditësja, si pasojë e aksidentit të shkaktuar, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare, në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet fizik, ka përjetuar disa sekonda. Frikë sekondare të intensitetit të lartë, ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 muaj, kurse frikë sekondare të intensitetit të ulët në ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3 muaj, e shoqëruar me ankthe të herëpashershme, shqetësime gjatë gjumit, brengës për ecurin e mjekimit, indisponim, shqetësim emocionale dhe pasiguri sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion..

Ekspertët, po ashtu kanë konstatuar se shpenzimet e prezantuara nga paditësja, i përgjigjen lëndimit të pësuar në aksident komunikacioni.

Gjykata të dy ekspertizat mjekësore atë të ortopedisë - traumatologjisë dhe psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar duke ofruar të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore baza juridike e kërkesëpadisë është në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe Ligjit Nr.04/L077 për marrëdhëniet e detyrimeve, e posaçërisht në dispozitat në vijim.

Me nenin 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, është përcaktuar mbulesa siguruese, ashtu që sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit

motorik. Kurse me nenin 10 të tij përcaktohet e drejta për kompensim për dëmin material dhe jo material, e cila duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve. Ndërsa me nenin 18, paragrafi 1 dhe 2, të ligjit të njëjtë është përcaktuar se “Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja. 2. Në rast dëmi të shkaktuar nga mjete motorik sipas paragrafit 1. të këtij ligji.”

Ligji Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material), ashtu që me nenin 136, paragrafi 1 është përcaktuar se kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Me nenin 140 përcaktohet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”. Kurse me nenin 159, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se “në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”.

Me nenin 137 të të njëjtit ligjit përcaktohet se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Kurse me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.

Prandaj, gjykata duke u bazuar në këto dispozita si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditëses, vlerësimit në ekspertizave mjekësore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi kërkesëpadinë e paditëses në shumë prej 1,440.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se paditësja, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore: ndrydhje e kokës, distorzion të unazave të qafës, ndrydhje të kafazit të kraharorit, ndrydhje e regjionit lumbal, ndrydhje dhe

gërvishtje të regjionit të dy parakrahëve (dëmtim i shtresës sipërfaqësore të lëkurës së parakrahut të djathtë), dhe ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë në kohëzgjatje prej 15 minutave, dhimbje të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 2 ditë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 15 ditë, kurse dhimbjet me intensitet të ulët janë ende të pranishme tek paditësja.

Në emër të kompensimit lidhur me frikën për paditësen, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,152.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza nga lëmi i psikiatrisë është provuar se paditësja ka përjetuar frikë primare disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 2 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 1 muaj dhe frika sekondare të intensitetit të ulët 3 muaj.

Prandaj, gjykata duke u bazuar në këto dispozita si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuar për paditësen, vlerësimin të ekspertizave mjekësore, gjykata miratohet pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar e në vlerën e shpërblimit të dëmit si në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se shumatat e kompensimit të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses dhe se lartësia e kompensimit në të hollave, do t'i mundësojë paditëses satisfaksionin që ai të jenë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po që se i njëjti nuk do t'i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuar, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, kohën e nevojshme të shërimit dhe moshën e të dëmtuarit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën e kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 183 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar, ndihmë e kujdes të huaj, dhe shpenzimet e shërimit, ka aprovuar shumatat si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 179, paragrafi 1 të Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si

dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditëses i takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësja për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditëses i takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjertanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, e cila përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Këto kategori të kompensimit, janë të njohura edhe me Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga auto përgjegjësia, e cila nuk është obliguese për gjykatat në rastin e vendosjes, por mund të merret si kriter orientues, rezulton se kompanitë e sigurimeve në rastet e aksidenteve të komunikacionit, të dëmtuarve u njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdesin dhe ndihmën e huaj nga personi i tretë. Andaj gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësen, ka aprovuar kërkesëpadinë në shumë prej 200.00€, brenda kufijve të kërkesës, kjo bazuar në konstatimin e ekspertit ortoped - traumatolog, si pasojë e aksidentit paditësja ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 4 javë, i pajisur minerale, albumina dhe vitamina, ushqim më shumë i përforcuar se ai i zakonshmi

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj për paditësen Gjykata ka caktuar kompensimin në shumë nga 150.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë, si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për t'i kryer aktivitetet e përditshme jetësore dhe atë në kohëzgjatje prej 15 ditëve.

Gjykata për kategoritë e dëmit ushqim i përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes i huaj, vlerëson se mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore. Andaj, gjykata, me çmuarje të lirë dhe konform nenit 323 të Ligjit për procedurën kontestimore Nr. 03/L-006, ka ardhur në përfundim se shumatat e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave. Vlëra e njohur për këto shpenzime janë të bazuara në praktikën gjyqësore për këtë lloj të kompensimit, përputhen me kohëzgjatjen e nevojës për ushqim të përforcuar dhe për kujdes të personit të tretë.

Gjykata ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses lidhur me shpenzimet e shërimit, në

shumë prej 506.35€, pasi që nga provat e administruara, si kuponët fiskal numër 14 i datës 10.08.2017, i datës 03.08.2017 lëshuar nga Star Pharm, numër 6 i datës 31.08.2017, numër 7 i datës 31.08.2017, numër 8 i datës 11.08.2017, numër 13 i datës 09.08.2017, numër 10 i datës 11.09.2017, numër 0008 i datës 29.08.2017, numër 10 i datës 14.09.2017, numër 9 i datës 14.09.2017, numër 13 i datës 25.08.2017, numër 1 i datës 23.11.2017, numër 1 i datës 20.10.2017, numër 1 i datës 14.10.2017, numër 0046 i datës 02.08.2017, numër 3 i datës 16.10.2017, numër 1 i datës 18.10.2017, numër 1 i datës 11.10.2017, numër 1 i datës 02.10.2017, numër 8 i datës 09.10.2017, numër 1 i datës 06.10.2017, numër 2 i datës 09.10.2017, numër 2 i datës 04.10.2017, numër 0107 i datës 29.08.2019, numër 1 i datës 02.10.2017, numër 1 i datës 06.10.2017, dëftosat me numra 0112741, 0214771, 156819, 092588, 089996, 265286, është provuar se e njëjta ka pasur shpenzime të shërimit në shumën e aprovuar dhe se këto shpenzime, bazuar në ekspertizën mjekësore të datës 27.07.2023, i përgjigjen lëndimit të pësuar në aksident komunikacioni.

Gjykata, ka vendosur si në pikën –IV- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses që ndërlidhet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Kurse sa i përket dëmit material, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket ndihmës dhe kujdesit të personit të huaj në shumë prej 50.00€ dhe shpenzimet e rehabilitimit klimaterik në shumë prej 600.00€, kjo nga se në vlerësimin e gjykatës shumat e gjykuara për kategorinë e kujdesit të personit të huaj janë në harmoni me qëllimin e kompensimit dhe praktikën gjyqësore për këtë lloj kompensimi. Kurse sa i përket shpenzimeve të rehabilitimit klimaterik dhe shpenzimeve të shërimit, paditësja nuk ka provuar shpenzime të krijuara për këtë qëllim. Bazuar në dispozitën e nenit 7 dhe 322 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, paditësja ka pasur barrën e provës për të provuar këtë shpenzim, i njëjti nuk ka provuar shpenzimet e bëra për këtë kategori të kompensimit.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditëses i takon edhe kamatëvonesa, e përcaktuar me nenin 382 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Kamata, për dëmin material fillon të rrjedh nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, 29.09.2017, ndërsa për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi,

përkatësisht data 29.09.2023, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449, 452 dhe 453 të LPK-së, sipas të cilave paditëses u pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 849.60€ dhe atë: në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 104.00€, për përfaqësim të paditëses nga avokati në tri seanca gjyqësore shumën 405.60€ (3 seanca nga secila seancë nga 135.20 €), për taksë për padi shumën prej 40.00€ dhe për ekspertiza mjekësore shumën prej 300.00€. Gjkata nuk ka njohur shpenzimet mbi shumën prej 849.60€, kjo bazuar në paragrafin 5 të nenit 452 të LPK-së, dhe atë shumën prej 104.00€ për parashtrësën e datës 23.08.2023 për precizin e kërkesëpadiisë, të dorëzuar në seancën e shtyrë të shqyrtimit kryesor të datës 04.09.2023, pasi që në vlerësimin e gjykatës ky kompensim është konsumuar me shpenzimet e njohura për padi dhe se parashtrësja në fjalë ka të bëjë me rregullimin e padisë në kuptimin objektiv.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.2552/17, me datë 29.09.2023

Gjyqtari
Nexhat Qallapeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.